



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.144/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Podujevë, për shkak të vendosjes së posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Podujevë, kështu që subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Podujevë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014 Lëvizja Vetëvendosje dega në Podujevë ka parashtruar ankesë në PZAP me të cilën pretendon se me datën 04.06.2014 diku rreth orës 11:56 aktivistët e LVV-së kanë vërejtur se mbi rrugën “ Zahir Pajaziti “ në Podujevë, është vendosur poster i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Safet Nishevcu nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 4 paragrafi 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 120 paragrafi 1 pika a), subjektin politik Nisma për Kosovën e informoi dhe Urdhëroi që të ndërmarr masat përmirësuese lidhur me ankesën më datën 05.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 06.06.2014 në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Nisma për Kosovën në të cilën deklaroi se pas marrjes së shkresës nga PZAP-i, i kanë lajmëruar degën e Nismës në Podujevë dhe ka ndërrmarr të gjitha masat përmirësuese ku me ç’rast i kanë larguar posterin për të cilat është parashtruar ankesa

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, Safet Nishevcit është vendosur mbi rrugë publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstatoi se subjekti politik Nisma për Kosovën, në këtë rast ka thyer Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët e tyre dhe duke u bazuar në shkallën dhe peshën e shkeljes për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë, me qenë se subjekti politik në fjalë merrë pjesë për herë të parë në Zgjedhje si subjekt politik, dhe se heqja e posterit sipas urdhrit të PZAP-it është realizuar kjo merret si rrethanë lehtësuese në shqiptimin e gjobës . Andaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

Anr.144 /2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga*

PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.